

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5817
E mërkurë, 3 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Kosnetti: Qeveria të
veprojë shpejt për
kontratën e homologimit
të automjeteve | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI | FAQE 4-5

Të jemi vigjilentë dhe të matur me situatën në veri

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, u ka bërë thirrje institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që të jenë vigjilente nga provokimet e Serbisë në veri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se simulimi i krizës humanitare në atë pjesë është një provokim i hapur i Serbisë për ta destabilizuar pjesën

veriore të vendit. Sipas saj, me veprime të tilla shteti serb po vazhdon ta tregojë mentalitetin hegjemonist. Tahiri ka thënë se pret që dialogu Kosovë - Serbi të rifillojë në muajin tetor, menjëherë pas ndryshimit të lidërshimit të BE-së. Deri atëherë, sipas saj, Kosova duhet të ndërtojë një ekip serioz të unitetit



AKTUALE



**THAÇI, DEPUTETËVE:
MOS I INJORONI KËRKESAT E
SHQIPTARËVE TË LUGINËS** F. 7

**KOSOVA E 100-ta, SHQIPËRIA
E 52-TA PËR NGA FUQIA E
PASAPORTËS** F. 5

**THEMELOHET QENDRA
'GJENOCIDI NË
KOSOVË - PLAGË E HAPUR'** F. 7

EKONOMI



**HARADINAJ THOTË SE
DUHET TË BËHET NJË
LINJË HEKURUDHORE
KOSOVË - DURRËS** F. 9

**MINISTRIA E TREGTISË
VERIFIKON PESHORET E
MULLINJVE PARA SEZONIT TË
KORRJE-SHIRJEVE** F. 8

SPORT

**LIGJI PËR SPONSORIZIM JEP
SHKËNDIJAT E PARA** F. 16



GJYKATA E APELIT KA VËRTETUAR PAFAJËSINË E FATMIR LIMAJT NË RASTIN E MTPT-së

Limaj: Gjykata e Apelit i dha fund një persekutimi të pashembullt



Gjykata e Apelit e ka refuzuar të pabazuara ankesën e Prokurorisë Speciale kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve në rastin e MTPT-së. Pas këtij vendimi ka reaguar Fatmir Limaj, i cili ka thënë se Gjykata e Apelit vulosi edhe një

herë pafajësinë e tij dhe të bashkëpunëtorëve të tij në rastin e MTPT-së. "Sot është fundi i një persekutimi të pashembullt, i një rasti të orkestruar nga individë të cilët, në pamundësi për t'u ballafaquar me argumente dhe fakte, fabrikuan prova

për të më përlyer mua dhe familjen time", ka thënë Limaj, duke shtuar se drejtësia e pavarur, e pandikuar, siguria juridike, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, do të jenë angazhimi dhe përkushtimi i tij kryesor

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kosova dhe Shqipëria me përfaqësi të përbashkëta diplomatike

TIRANË, 2 KORRIK - Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar të martën marrëveshjen ndërministrorë për bashkim të përfaqësive diplomatike e konsullore dhe për bashkëpunim strategjik në fushën e politikës së jashtme. Marrëveshja u firmos nga ministri i punëve të jashtme të dy vendeve, Gent Cakaj dhe Behgjet Pacolli.

Në konferencën e përbashkët me gazetarë, homologët sqaruan se marrëveshja konsiston në katër shtylla kryesore: politike, diplomatike, profesionale dhe kulturore.

"Ne do të punojmë në interesa të dy shteteve së bashku, por de facto dhe de jure do të punojmë dhe do shihni se rezultatet do jenë më të mëdha. Jetojmë në një kohë kur politika dhe interesat e shteteve të ndryshme kanë ndryshuar dhe ne duhet t'i adaptohem këtij realiteti. Adaptimi ynë fillon edhe nëpërmjet kësaj marrëveshje dhe do jetë më tepër në vendet ku nuk kemi qenë deri tani. Duhet të hapim diplomacitë. Ka një mori vendesh ku ne operojmë si dy entitete dhe unë mendoj se kjo është e tepërt. Ne duhet që këto

energji t'i bashkojmë dhe të veprojmë së bashku, që ne të kemi përfaqësi të përbashkëta. Nëse ne jemi të aftë të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin do jemi të aftë të bashkëpunojmë edhe me të tjerët", tha Cakaj.

"Falënderoj kryeministrin që ka mbështetur këtë proces. Së bashku do jemi më të fortë dhe më të respektuar në sytë e të tjerëve. Ju garantoj se Kosova është dhoma tjetër e shtëpisë sonë, dhe atje do ketë gjithmonë dyer të hapura për vëllezërit tanë nga Shqipëria", theksoi Pacolli.



Meta kërkon zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe presidenciale

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, të martën në një konferencë me gazetarë ka propozuar që për zgjidhjen e krizës politike më 13 tetor të mbahen zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe për presidentin dhe tha se do të kandidojë sërish për postin e presidentit

TIRANË, 2 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, të martën propozoi që për zgjidhjen e krizës më 13 tetor të mbahen zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe për presidentin.

Në një konferencë për gazetarë, Meta tha se ky është propozimi i tij për zgjidhjen e krizës politike që vijon edhe pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale më 30 qershor. Ai tha se do të kandidojë sërish për postin e presidentit në këto zgjedhje të 13 tetorit që ai propozon, dhe thotë se kryeministri Edi Rama mund të vërë cilin kandidat të dëshirojë. "Kjo është rruga që e zgjidh këtë krizë", tha Meta në konferencë duke shtuar se "unë do të garoj për president me këto kompetenca që kam. Kjo është rruga që e zgjidh këtë krizë që shqiptarët të mos shkojnë sërish të futen nëpër ambasada. Boll e zbrazëm Shqipërinë. Do ta bëjmë një vend evropian, një vend ku askush nuk dhunon ligjin dhe institucionet. Kjo është zgjidhja që unë jap dhe nuk është turp as

për mua nëse populli nuk më voton. Kjo është rruga e zgjidhjes së krizave. Nëse ka ndonjë propozim për kandidat për president, Edi Rama ta bëjë. Të mos tallet askush me Kushtetutën tonë. U tallën njëherë në 2008-n", tha presidenti Meta.

Ai tha se nuk është krizë politike, por krizë e shtetit. "Kjo është një krizë e shtetit të së drejtës dhe kryetar i shtetit është presidenti", tha Meta.

Presidenti tha se alternativa e tij për zgjidhjen e krizës ishte një agjendë ndryshe nga ajo e opozitës joparlamentare, që është Rama ik. Ajo ishte Rama reflekto, që pas zgjedhjeve të 30 qershorit, sipas Metës, është kthyer në Rama kthjellohu. Duke iu drejtuar kryeministrit Edi Rama për zgjedhjet e 30 qershorit, ai foli për një "turp e skandal, as 10 për qind nuk ka marrë, le t'i mbushin kutitë të tërë ditën me organizatën socialiste në KQZ, me kolegjin socialist, tregon se çfarë reforme në drejtësi po bën, nga reformë e ka



bërë Ramaformë. Këto janë gjëra të turpshme dhe skandaloze që nuk mund të ndodhin në një shtet të së drejtës e që do të anëtarësohet në BE. Për mua demokracia është e panegociueshme, nuk e negocioj me asnjë ambasadë e asnjë shtet", tha Meta.

"Nëse nuk je i pavarur të marrësh vendimet e duhura, unë dhe gjithë shqiptarët e ndershëm që kanë ende gjak

shqiptari do ta mbrojnë Shqipërinë nga gjithë ata miliardarë që i duket Shqipëria mizë lisi e mund të tallen", tha Meta. Gjatë konferencës me gazetarë, pas procesit të 30 qershorit, kreu i shtetit tha se dekretin e tij të fundit, që caktoi datën 13 tetor për zgjedhjet lokale, nuk mund ta gjykojë Kolegji Zgjedhor, por vetëm Gjykata Kushtetuese e cila ende nuk është funksionale dhe pritet të krijohet në fund të kor-

rikut. "E ftoj Ramën të tregohet i përgjegjshëm. I ftoj përfaqësuesit e huaj të mos bëhen qesharakë. Të mos tallen me Kushtetutën tonë. Sepse u tallën një herë në 2008-n. Duhet t'i zgjidhim çështjet vetë këtu si burra shteti", tha ai.

Meta foli për një grup të strukturuar që funksionon në Shqipëri dhe që, sipas tij, bazohet në parimet e "deep state" dhe "state capture".

Ursula von der Leyen, presidente e Komisionit Evropian?

Bruksel, 2 korrik - Sipas burimeve të cituara nga agjencia e lajmeve Reuters, ministrja gjermane e Mbrojtjes Ursula von der Leyen mund të zgjidhet presidente e Komisionit Evropian.

Sipas të njëjtit burim, shefja e

Fondit Monetar Ndërkombëtar, Christine Lagarde mund të bëhet presidentja e re e Bankës Qendrore Evropiane, pas një marrëveshjeje midis Francës dhe Gjermanisë.

Një burim diplomatik tha se pres-

identi francez Emmanuel Macron i kishte propozuar homologes së tij gjermane Angela Merkel që Lagarde të merrte postin e lartë të Bankës Qendrore Evropiane.

Sipas këtij burimi, Merkel u

shpreh "shumë pozitivisht" për këtë propozim.

Të 28 liderët e BE-së janë mbledhur në Bruksel për të zgjedhur kërret e rinj të Unionit, mes të cilëve edhe kreun e Komisionit Evropian.



Gjykata e Apelit ka vërtetuar pafajësinë e Fatmir Limajt në rastin e MTPT-së

Limaj: Gjykata e Apelit i dha fund një persekutimi të pashembullt

Gjykata e Apelit e ka refuzuar të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve në rastin e MTPT-së. Pas këtij vendimi ka reaguar Fatmir Limaj, i cili ka thënë se Gjykata e Apelit vulosi edhe një herë pafajësinë e tij dhe të bashkëpunëtorëve të tij në rastin e MTPT-së. "Sot është fundi i një persekutimi të pashembullt, i një rasti të orkestruar nga individë të cilët, në pamundësi për t'u ballafaquar me argumente dhe fakte, fabrikuan prova për të më përlyer mua dhe familjen time", ka thënë Limaj, duke shtuar se drejtësia e pavarur, e pandikuar, siguria juridike, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, do të jenë angazhimet e tij kryesore

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 KORRIK - Gjykata e Apelit e ka refuzuar të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve në rastin e MTPT-së. Në këtë mënyrë, Apeli ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 30 maj 2018.

Në njoftim e Gjykatës së Apelit thuhet se Fatmir Limaj, Endrit Shala, Nexhat Krasniqi, Florim Zuka dhe Shpëtim Tulaku akuzoheshin nga prokuroria për shkak të veprës penale nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës si krim i organizuar, keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizim, marrje dhe brifizë, dhënie e ryshfetit, keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi dhe vepra të

tjera penale në formë të mosdeklarimit të parave të pranuar për fushatë, parashikuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2 për pengimin e shpëlarjes së parave dhe veprave të ngjashme penale. Gjykata gjeti se shkalla e parë nuk ka bërë shkelje esenciale procedurale, ka aplikuar drejtën penale si dhe ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen

faktike.

Pas këtij vendimi ka reaguar Fatmir Limaj, i cili ka thënë se Gjykata e Apelit vulosi edhe një herë pafajësinë e tij dhe të bashkëpunëtorëve të tij në rastin e MTPT-së. "Sot është fundi i një persekutimi të pashembullt, i një rasti të orkestruar nga individë të cilët, në pamundësi për t'u ballafaquar me argumente dhe fakte, fabrikuan prova për të më përlyer mua dhe familjen time. Vendimi i sotëm i Gjykatës së Apelit është fitore e drejtësisë dhe shpresë për të gjithë njerëzit që nuk duhet të dorëzohen në kërkim të drejtësisë. Vendimi i Apelit është goditje për segmente të caktuara brenda sistemit të drejtësisë, të cilat kanë qenë të thirrura për të vënë drejtësi, por iu shërbyen grupeve të ndryshme të interesit për t'i goditur njerëzit që me tërë

qenien kanë qenë në të drejtën e Zotit dhe ligjit dhe në shërbim të vendit", ka thënë Limaj.

Ai ka shtuar se që nga viti 2003 është përballur me procese gjyqësore, por asnjëherë nuk është dorëzuar, pasi ka qenë i bindur që në çdo periudhë i ka shërbyer me devotshmëri vendit. "Kam besuar në Zot dhe drejtësi dhe kam punuar fort që para qytetarëve të dëshmoj se i kemi shërbyer vendit me pastërti e dashuri dhe, siç e vërtetoi edhe vendimi i Gjykatës, në respekt të ligjit. Drejtësia e pavarur, e pandikuar, siguria juridike, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do të jenë angazhimi dhe përkushtimi im kryesor. Falënderoj çdo qytetar të këtij vendi që besoi në fjalën time, më mbështetën dhe qëndruan afër në kohët më të vështira për mua dhe familjen time", ka deklaruar Limaj.



Kosnetti: Qeveria të veprojë shpejt për kontratën e homologimit të automjeteve

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të veprojë shpejt ndaj rezolutës së Kuvendit për çështjen e homologimit të automjeteve. "Qeveria duhet të veprojë shpejt, pas rezolutës së Kuvendit dhe të hapë një proces të lirë dhe të konkurrencës së drejtë", ka shkruar Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter".

Ambasadori amerikan ka pohuar se ai ndanë shqetësimin sikurse Bashkimi Evropian, Kuvendi i Kosovës dhe Autoriteti i Konkurrencës për kontratën monopoliste për homologimin e automjeteve "që shtrembëron tregun dhe ngre çmimet për qytetarët".

Me 62 vota për dhe dy abstenime, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar të hënën rezolutën për ndalimin e monopolit në

homologim. Rezoluta e prezantuar nga deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Zharku, kërkon shfuqizimin e udhëzimit administrativ të vitit 2018 dhe fillimin e plotësim-ndryshimit të Projektligjit për automjete. Po ashtu, rezoluta kërkon që në afat prej dy muajve të miratohet udhëzimi i ri administrativ, ndërsa në afat prej gjashtë muajve të liberalizohet tregu i homologimit të automjeteve



Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

Të jemi vigjilentë dhe të m



Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, u ka bërë thirrje institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që të jenë vigjilente me provokimet e Serbisë në veri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se simulimi i krizës humanitare në atë pjesë është një provokim i hapur i Serbisë për ta destabilizuar pjesën veriore të vendit. Sipas saj, me veprime të tilla shteti serb po vazhdon ta tregojë mentalitetin e tij hegjemonist. Tahiri ka thënë se pret që dialogu Kosovë - Serbi të rifillojë në muajin tetor pas ndryshimit të lidershit të BE-së. Deri atëherë, sipas saj, Kosova duhet të ndërtojë një ekip serioz të unitetit

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka ftuar institucionet e Kosovës që të jenë vigjilente dhe të matura ndaj situatës në veri të vendit. Ajo ka deklaruar se nuk duhet të bien në provokime të rrejshme të Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka deklaruar se Serbia

përmes simulimit të krizës humanitare në veri po mundohet ta destabilizojë veriun e vendit. "Institucionet e Kosovës duhet të jenë vigjilente dhe të matura në mënyrë që të ruhet qetësia në veri të vendit. Nuk duhet të lejohen provokimet e rrejshme për një krizë humanitare në veri, në mënyrë që të mos jepet asnjë pretekst për ndonjë konflikt eventual, sepse kjo do të kishte pasojë për Kosovën

dhe gjithë rajonin", ka thënë Tahiri. Ajo ka bërë me dije se edhe faktorët ndërkombëtarë duhet të reagojnë ndaj këtyre provokimeve të rënda të Serbisë. "Apeli im shkon jo vetëm për institucionet e Kosovës, por edhe për faktorin ndërkombëtar, aleatët e Kosovës, ShBA-në dhe anëtarët e BE-së që ta mbështesin Kosovën dhe të mos lejojnë që

Serbia, e cila ka bërë tri gjenocide në Ballkan, t'i kthehet të kaluarës", është shprehur ajo. Tahiri ka folur edhe për mundësinë e vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi. Ajo ka thënë se ky proces nuk duhet të vazhdojë derisa të ndërrohet lidershipi i BE-së. "Ky dialog nuk duhet të vazhdojë derisa të ndryshojë lidershipi i BE-së i cili është në ndryshim e sipër. Vetë znj. Mogherini si ndërmjetësuese e dialogut ka shkelur parimet evropiane të procesit, duke lënë hapësirë që të bisedohet për ndryshimin e kufijve dhe dëmtimin e Kosovës. Pra, duhet të pritët shkuarja e Mogherinit dhe e atyre që ishin në vijën e lojërave të rrezikshme për ndryshim të kufijve, pastaj kur të konsolidohet lidershipi i ri i BE-së duhet të rinisë dialogu. Kjo i bie se mund të

ndodhë diku kah muaji tetor", është shprehur Tahiri. Sipas saj, gjatë kësaj kohe Kosova duhet të bëjë përpjekje për ta ndërtuar një ekip serioz të unitetit për këtë proces, i cili do të duhet t'i përfaqësonte pozitën dhe opozitën.

"Epoka e re": Znj. Tahiri, Serbia po bën përpjekje për të simuluar një katastrofë humanitare në veri të vendit duke i shtyrë serbët lokalë t'i mbyllin të gjitha dyqanet. Çfarë do të thotë për ju një veprim i tillë?

Tahiri: Ky veprim apo intervenim i Serbisë është me prapavijë djallëzore. Serbia ende nuk ka hequr dorë nga lojërat për kufij dhe i gjithë synimi i saj është hegjemonist. Ajo po tenton që në mënyrë artificiale të krijojë situatë destabilizuese për të përdorur si argument për ta

atur me situatën në veri



duhet të lejohen provokimet e rrejshme për një krizë humanitare në veri, në mënyrë që të mos jepet asnjë pretext për ndonjë konflikt eventual, sepse kjo do të kishte pasoja për Kosovën dhe gjithë rajonin. Siç e kam thënë edhe më herët, prekja e kufijve ekzistues të Kosovës nuk mund të mbetet e izoluar. Një veprim i tillë do të përshkallëzohej në ndryshim kufijsh për të gjithë Ballkanin. Pra, jemi në një situatë të rëndë të provokimit nga ana e Serbisë, e njohur si faktor destruktiv në Ballkan edhe sot e kësaj dite. Apeli im shkon jo vetëm për institucionet e Kosovës, por edhe për faktorin ndërkombëtar, aleatët e Kosovës, ShBA-në dhe anëtarët e BE-së që ta mbështesin Kosovën dhe të mos lejojnë që Serbia, e cila ka bërë tri gjenocide në Ballkan, t'i kthehet të kaluarës.

"Epoka e re": Pas mbylljes së dyqaneve në veri, Qeveria e Kosovës, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve, ka hapur pikat shitëse në bashkëpunim me bizneset. Ka qenë veprim i duhur ky?

Tahiri: Ky veprim ishte jashtëzakonisht i mirëseardhur. Kjo jep një mesazh për qytetarët e Kosovës në veri, sidomos për ata të komunitetit serb, se ata janë pjesë e barabartë e shtetit të Kosovës dhe ky shtet interesohet për ta. Siç e dimë të gjithë, për shtatë vjet sa kam udhëhequr bisedimet e Brukselit ne kemi arritur ta vëmë kufirin në veri me Serbinë. Me marrëveshje kemi shuar strukturat paralele në atë pjesë, ka filluar integrimi i serbëve të veriut në institucionet e Kosovës dhe funksionimi i shtetit të Kosovës. Ky zhvillim shtatëvjeçar ka qenë jashtëzakonisht pozitiv. Më herët është kritikuar dialogu i Brukselit dhe jam kritikuar edhe unë, por tani secili po e sheh se kemi pasur arritje të mëdha për shtrirjen e sovranitetit në veri të vendit. Mirëpo po e përsëris se loja për ndryshimin e kufijve ka krijuar një situatë jo të mirë, por e rëndësishme është se këtë çështje e kemi mbyllur me ndihmën edhe të aleatëve tanë. Veçmas Samiti i Berlinit dhe kancelarja Merkel ka qenë e qartë që nuk ka ndryshim të kufijve në mes të dy vendeve. Të gjithë duhet ta dinë se kjo çka po bën Serbia tani është një rikthim në politikë të agresionit për ta marrë veriun e Kosovës. Prandaj, kjo duhet të kundërshtohet nga ne dhe nga faktori ndërkombëtar.

"Epoka e re": Ky skenar i Serbisë erdhi nga dështimi i Samtit të Parisit?

Tahiri: Nuk do të thosha se ky reagim ka ardhur vetëm për shkak të dështimit të Samtit të Parisit. Kjo po vjen nga mentaliteti hegjemonist i Serbisë, ku të gjithë po e shohin se Serbia ende nuk ka hequr dorë nga Serbia e madhe. Pavarësisht se po kërkon të bëhet anëtare e BE-së, ajo nuk i respekton parimet evropiane për Ballkanin, ku kanë lindur disa shtete të reja, e të cilat janë anëtarësuar në BE ose janë në rrugë të anëtarësimit. 23 vende të BE-së e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Mendoj se ky është një mesazh mjaft i qartë për Serbinë se ky shtet nuk mund t'i prekë kufijtë dhe të krijojë Serbinë e madhe. Serbia ka një mbështetje nga Rusia, e cila ka interesa që

duke destabilizuar Ballkanin ta rrisë influencë në Ballkan sikurse ka bërë me intervenimin në Ukrainë dhe vende të tjera. Pra, kemi të bëjmë me skenarë ndërkombëtarë të ndikuar nga Rusia, ku Serbia është satelit i Ruisë në Ballkan për gjëra të këqija.

"Epoka e re": Si e shihni vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi? Kur mund të ndodhë rinisja e këtij procesi?

Tahiri: Së pari ky dialog nuk duhet të vazhdojë derisa të ndryshojë lidhshipi i BE-së i cili është në ndryshim e sipër. Vetë znj. Mogherini si ndërmjetësuese e dialogut ka shkelur parimet evropiane të procesit, duke lënë hapësirë që të bisedohet për ndryshimin e kufijve dhe dëmtimin e Kosovës. Pra, duhet të pritët shkuarja e Mogherinit dhe e atyre që ishin

në vijën e lojërave të rrezikshme për ndryshim të kufijve, pastaj kur të konsolidohet liderishpi i ri i BE-së duhet të rinisë dialogu. Kjo i bie se mund të ndodhë në muajin tetor. Mendoj se deri atëherë Kosova duhet të ndërtojë një ekip serioz të unitetit për këtë proces, sepse nuk mund të shkohet në bisedime për njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë me një ekip që ka qenë me legjitimitet të pamjaftueshëm dhe sot ai është ekip jokushtetues. Dihet që dialogu me armikun nuk është i thjeshtë dhe ata që do të jenë pjesë e këtij procesi duhet ta dinë se kjo është një detyrë shumë e rëndësishme dhe vetëm një ekip i duhur i unitetit krijojnë legjitimitet. Pra, ekipi duhet ta përfaqësojë spektrin e gjerë të pozitës dhe opozitës.

Kosova e 100-ta, Shqipëria e 52-ta për nga fuqia e pasaportës

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kosova është në vendin e 100 në botë për nga fuqia e pasaportës, pasi qytetarët e saj mund të udhëtojnë pa viza në vetëm 41 vende. Ky është rezultati i një hulumtimi të kompanisë "Henley Passport Index" që flet për fuqinë e pasaportave të shteteve të botës bazuar në 'lirinë e lëvizjes së bartësit të një pasaporte në shtete të ndryshme, pa pasur nevojë për vizë'. Pas Kosovës, në vendin e 101

janë Bangladeshi, Eritrea, Libani dhe Korea Veriore. Nga vendet e rajonit, Serbia është në vendin e 41-të, qytetarët e së cilës mund të udhëtojnë pa viza në 131 vende, Mali i Zi i 47-ti me 122 vende, Maqedonia e Veriut në vendin e 46, qytetarët e së cilës mund të lëvizin pa viza në 123 vende, Bosnje dhe Hercegovina renditet 51-ta me 116 vende dhe Shqipëria në pozitën e 52-të me 113 vende.

Në vendin e 109 dhe të fundit në listë renditet Afganistani. Qytetarët e këtij vendi mund të udhëtojnë pa viza në vetëm në 25 vende. Pasaportat më të fuqishme në botë, sipas kësaj organizate, janë të Japonisë dhe Singaporit, pasi qytetarët e këtyre vendeve mund të udhëtojnë pa viza në 189 vende. Rezultatet e këtij hulumtimi janë bazuar në të dhënat ekskluzive nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror.



ndarë Kosovën. Ne të gjithë jemi dëshmitarë se ka pasur disa lojëra kohën e fundit për ndryshim të kufijve. Serbia ishte në një angazhim dhe pritje të madhe që do të mund ta ndajë Kosovën, por ne nuk e lejuam një gjë të tillë. Ne, themeluesit e shtetit, dhe partitë politike u ngritëm me vendosmëri dhe u thamë jo këtyre lojërave. E dimë të gjithë se pjesë e këtyre lojërave ishin edhe presidenti Thaçi, kryeministri Rama, presidenti serb, dhe Rusia e cila ishte kryesponsorja e destabilizimit të kufijve.

"Epoka e re": Cili duhet të jetë reagimi i institucioneve të Kosovës dhe faktorit ndërkombëtar karshi kësaj situatë?

Tahiri: Institucionet e Kosovës duhet të jenë vigjilente dhe të matura në mënyrë që të ruhet qetësia në veri të vendit. Nuk

2 korriku i 1990-s , bazament i platformës për pavarësi



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, me rastin e 29-vjetorit të shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, ka pritur në takim ish-delegatët e Kuvendit të Kosovës të cilët ishin pjesëtarë të këtij momenti historik. Veseli ka thënë se me këtë akt Kosova forcoi unitetin kombëtar brenda saj dhe krijoi bazamentin e platformës për pavarësi

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, në 29-vjetorin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, ka pritur në takim ish-delegatët të Kuvendit të Kosovës të cilët ishin pjesëtarë të këtij momenti historik. Duke uruar ish-delegatët e Kuvendit të Kosovës, kryeparlamentari Veseli ka thënë se 2 korriku i vitit 1990 përbën një datë të shënuar të historisë së Kosovës. Ai ka thënë se me këtë akt Kosova jo vetëm iu kundërvu agresionit kushtetues të Serbisë, por forcoi unitetin kombëtar brenda saj dhe krijoi bazamentin e platformës për pavarësi, që u

konsolidua në vitet pasuese dhe kulmoi me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke u bërë realitet më 17 shkurt 2008, pikërisht në këtë Kuvend. Udhëheqësi i delegacionit, Iliaz Ramajli, ka falënderuar kreparelamentarin Veseli për pritjen e përvitshme dhe kujdesin e vazhdueshëm ndaj kësaj date me rëndësi të madhe historike. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës shprehën vullnetin e qytetarëve tanë për liri dhe pavarësi nga ish-Jugosllavia. "Pas shumë zhvillimeve politike, ky synim u bë realitet dhe sot Kosova është shtet i lirë, i pavarur dhe demokratik. Edhe në këtë përvjetor shprehim falënderim dhe respekt për të

gjithë delegatët e guximshëm të 2 korrikut", ka thënë Thaçi. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990 shënon pikënisjen e shtetësisë së Kosovës. "Kjo ditë, që i dha kah të ri përpjekjeve tona për liri dhe pavarësi, është rezultat i përpjekjeve shekullore të popullit tonë për ta realizuar idealin e lirisë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se gratë dhe burrat, që e vulosen vullnetin e popullit tonë, do të kujtohen dhe lartësohen nga brezat për përpjekjen e tyre për jetësimin e ëndrrës shekullore, shtetit të pavarur.

Me rastin e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut, kryetari i LDK-së, Isa Mustafa,

ka thënë se miratimi i Deklaratës Kushtetuese më 2 korrik 1990 ishte akti me rëndësi vendimtare për historinë e re të Kosovës. "Kjo deklaratë ishte padyshim pikënisje e ndërtimit të shtetësisë së Kosovës. Ky akt me vlera të veçanta historike ishte, gjithashtu, shprehje e aspiratave të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Shpreh mirënjohje të thellë për deputetët e Kuvendit të atëhershëm të cilët me përkushtim dhe vendosmëri në rrethana të jashtëzakonshme miratuan këtë deklaratë, duke shpallur Kosovën njësi të barabartë në federatën jugosllave. Përpjekjet e popullit të Kosovës për pavarësi do të kujtohen në të gjithë brezat", ka deklaruar Mustafa.

Ndërkaq lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vlerësuar se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990 ka hyrë dhe ka mbetur në historinë tonë si akt i rëndësishëm ngase delegatët shqiptarë të Kuvendit të

Kosovës e miratuan atë në rrethana tepër të jashtëzakonshme.

Limaj ka thënë se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut është akt themeltar i shtetësisë së Kosovës. "29 vjet më parë, pikërisht më 2 korrik të vitit 1990, delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën Kushtetuese me të cilën Kosova u shpall njësi e pavarur në kuadër të Federatës - Konfederatës së Jugosllavisë. Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990 është akt themeltar i shtetësisë së Kosovës ngaqë buroi nga vullneti sublim i popullit shqiptar të Kosovës. Deklarata Kushtetuese ka hyrë dhe ka mbetur në historinë tonë si akt i rëndësishëm ngaqë delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës e miratuan në rrethana tepër të jashtëzakonshme. Mirënjohës delegatëve të legjislaturës së vitit 1990, të cilët me aktin e tyre kryen një obligim moral, kushtetues dhe kombëtar", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Policia identifikon 58 fëmijë lëmshëkërkues

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (DHTQNJ), në kuadër të angazhimeve të vazhdueshme për parandalimin e dukurive negative, në veçanti luftën kundër abuzimit të fëmijëve, ka përpiluar një plan operativ të emëruar "Identifikimi i fëmijëve në situatë rruge si viktimë të mundshme të trafikimit" i cili plan është bërë në qershor të vitit 2019 dhe është zbatuar në gjithë territorin e Kosovës, nga



të gjitha njësitë e drejtorisë kompetente policore dhe aktorët e tjerë relevantë, si:

prokuroritë në rajonet përkatëse, qendrat për punë sociale, Drejtoria për Migrim

dhe të Huaj, njësitë e migrimit në kuadër të drejtorive rajonale të Policisë Kufitare (DRP-ve Kufitare), stacionet policore etj. Gjatë zbatimit të këtij plani operativ ka rezultuar me identifikimin e 58 fëmijëve lëmshëkërkues, prej tyre 21 shtetas të Kosovës dhe 37 shtetas të Shqipërisë, identifikimin e 42 lëmshëkërkuesve të rritur, prej tyre gjashtë shtetas të Kosovës dhe 36 shtetas të Shqipërisë, gjithashtu janë ngritur kallëzime penale ndaj tetë personave të dyshuar për veprën penale "keqtrajtim apo braktisje e fëmijës", neni 243

sipas Kodit Penal të RKS-së. "Të gjithë fëmijët lëmshëkërkues kanë qenë të shoqëruar nga familjarët e tyre dhe të pajisur me dokumente. Në prani të punëtorit social, të gjithë fëmijëve lëmshëkërkues u është plotësuar formulari për shënimet e lëmshëkërkuesve dhe janë marrë në pyetje familjarët e tyre, me qëllim të identifikimit të viktimave potenciale të trafikimit të njerëzve. Gjatë marrjes në pyetje nuk është identifikuar asnjë viktimë e trafikimit", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka publikuar draftrezolutën të cilën e ka dërguar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Thaçi, deputetëve: Mos i injoroni kërkesat e shqiptarëve të Luginës

Kryetari i shtetit, Hashim Thaçi, u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos i injorojnë kërkesat legjitime të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Ai ka thënë se shteti ynë e ka obligim që t'i mbështesë shqiptarët e Luginës për realizimin e kërkesave të tyre për bashkim me Kosovë. Përmes kësaj draftrezolute Thaçi ka kërkuar që çështja e Luginës së Preshevës të jetë pjesë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe përfaqësuesi i Luginës të jetë pjesë e delegacionit të bisedimeve



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 KORRIK - Presidenti Hashim Thaçi të martën ka publikuar draft-rezolutën për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën të cilën e kishte dërguar një ditë më parë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me këtë rast ai u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit që të mos i injorojnë kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës sepse, sipas Thaçit, Kosova e ka për obligim që t'i mbështesë ata për realizimin e kërkesave të tyre. "Kjo është draftrezoluta që ia kam dërguar për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. U bëj thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos i injorojnë kërkesat legjitime të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Ne e kemi obligim që t'i mbështesim në realizimin e kërkesave të tyre", ka shkruar presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka treguar se ka iniciuar këtë draftrezolutë duke marrë parasysh kërkesat e vazhdueshme të shqiptarëve të Luginës së Preshevës drejtuar institucioneve të Republikës së

Kosovës që të ndihmojnë në mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së tyre dhe realizimin e kërkesave historike të tyre.

Përmes kësaj draftrezolute të prezantuar nga presidenti Thaçi institucionet e Republikës së Kosovës obligohen që ta respektojnë vullnetin politik të shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën të shprehur me referendum të vitit 1992 dhe me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. "Kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, gjegjësisht shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre autoktone, në komunat e administruara nga Serbia: Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, sipas vullnetit të tyre të lirë për vetëpërcaktim, janë kërkesa legjitime, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, janë kërkesa që kanë të bëjnë me të drejtën historike e politike dhe me të drejta të një popullate që dëshiron të jetojë e lirë si të gjithë popujt e Evropës", është thënë në këtë draft-rezolutë.

Më tutje, është theksuar se kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës janë kërkesa që i ndihmojnë stabilitetit afatgjatë të rajonit dhe që kontribuojnë në vendosjen e paqes afatgjatë të rajonit dhe hapjes së një kapitul-

li të ri në marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Republika e Kosovës mbështet kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe të gjitha organet dhe institucionet e saj do t'i mbështesin këto kërkesa pa asnjë dallim politik apo dallim tjetër", është thënë në vazhdimin e draftrezolutës.

Me qëllim të mbështetjes së kërkesave legjitime të shqiptarëve të Luginës së Preshevës institucionet e Republikës së Kosovës duhet të kenë më shumë kujdes dhe interesim gjithëpërfshirës për t'i ndihmuar shqiptarët e Luginës së Preshevës në çdo sferë të jetës

dhe për t'i jetësuar kërkesat e tyre legjitime do të ndërmarrin hapat që përfshijnë, por nuk kufizohen si në vijim. "Kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës të jenë edhe pjesë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe përfaqësuesi i Luginës së Preshevës të jetë pjesë e delegacionit të bisedimeve. Çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës të ngritet në çdo forum ndërkombëtar që marrin pjesë përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës. Institucionet e Republikës së Kosovës të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë me institucionet e Republikës së

Shqipërisë për hartimin e platformës së përbashkët për shqiptarët e Luginës së Preshevës", është në draftrezolutën e propozuar nga presidenti Thaçi. Po të hënën deputetët e Kuvendit të Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme kanë debatuar për gjendjen dhe kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, por në mungesë kuorumi seanca është ndërprerë dhe nuk është arritur të miratohet një rezolutë me një serë kërkesash për Luginën e Preshevës. Kurse draftrezoluta e dërguar nga presidenti nuk është hedhur fare në debat nga ligjvënësit kosovarë.

Bytyqi e Kosnetti diskutojnë për një sistem arsimor me cilësi



PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip S. Kosnett, dhe drejtoreshën e misionit të USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, me të cilët ka biseduar për sistemin arsimor në Kosovë.

Ministri Bytyqi me këtë rast ka theksuar se është fokus i përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor me cilësi, e të vyer për vendin, shoqërinë dhe

ekonominë. "Në takimin e sotëm u pa si nevojë që në themelet e procesit të ketë transparencë, profesionalizëm dhe ruajtje të sistemit që të mos bie në margjina politike. Vëmendja e pareshur amerikane për përkushtimin dhe gatishmërinë në krah të arsimit tonë, ndërtimit të një sistemi funksional dhe profesional, e shprehur edhe në takimin e sotëm, na bënë ta shtojmë besimin se mund t'ia dalim", ka thënë ministri Bytyqi. Ai ka falënderuar ambasadorin Kosnett për vizitën, për qën-

drimin në krah të arsimit të Kosovës dhe mbështetjes amerikane. "Duke qëndruar në krye të detyrës ne do t'ia dalim ta bëjmë arsimin tonë një bazë suksesi për shoqërinë dhe ekonominë tonë", ka thënë ministri Bytyqi.

Ambasadori amerikan Philip S. Kosnett ka theksuar se sistemi i arsimit i bazuar në merita dhe transparencë është i domosdoshëm për t'ua mundësuar të gjithë qytetarëve të Kosovës të kontribuojnë në prosperitetin e saj.

Kërkohet mbështetje ndaj sektorit privat në aftësimin e të rinjve

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Zvogëlimi i boshllëkut të shkathtësive në fuqinë punëtore përmes iniciativave të bizneseve për aftësimin e të rinjve mbetet një praktikë mjaft e nevojshme për zhvillim të mëtutjeshëm, gjithsesi nevojitet mbështetje për nxitjen e praktikave të tilla në tërë vendin. Kjo u tha në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku u diskutua rreth iniciativave të ndërmarra nga sektori privat për zvogëlimin e hendekut të shkathtësive në Kosovë. Drejtori ekzekutiv i Odës

Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se ndër sfidat më të shpeshta që bizneset vendore hasin në operimet e tyre është boshllëku i shkathtësive të fuqia punëtore. Ai ka thënë se, pavarësisht prej ndërmarrjes së iniciativave të ndryshme nga sektori privat, bizneset vazhdojnë ende të ballafaqohen me këtë çështje e cila po ndikon mjaft në operimet e tyre.

Drejtori ekzekutiv i Cactus Education, Besim Ilazi, ka thënë se aftësimi i të rinjve nga ana e bizneseve, edhe pse po rezultojnë në përfitime në aftësimin profesional të tyre,

prapë kjo mbetet një barrë mjaft e madhe për sektorin privat.

Ilazi ka theksuar se edhe pse sektori privat ka marrë rolin e udhëheqësit në zvogëlimin e boshllëkut të shkathtësive, nuk po ka mbështetje në këtë aspekt, duke bërë thirrje që të ofrohen lehtësira për bizneset në këtë drejtim.

Udhëheqësi i Qendrës së Kompetencës dhe Iniciativave Strategjike në "Raiffeisen Bank Kosova", Kreshnik Halili, ka pohuar se iniciativat e ndërmarra nga kjo kompani për përgatitjen e punëtorëve kanë

rezultuar në punësim të një numri të madh të tyre në këtë ndërmarrje. Ai ka thënë se përfshirja e të rinjve në projekte me ndikim të madh në fazat e hershme të aftësimin të tyre ndikon në ngritjen e tyre profesionale, duke shtuar se përgjegjësi e tyre si biznes mbetet dhënia e një baze praktike në profesionin e të rinjve si dhe ekspozimin e tyre ndaj teknologjive të reja në sektorin bankar.

Shefi i Operimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në RIT Kosovo, Visar Jasiqi, ka thënë se përmes qendrës së trajnimeve

dhe zhvillimit nga ky institucion kanë synuar vazhdimisht aftësimin dhe përgatitjen e individëve për tregun e punës përmes trajnimeve profesionale dhe praktikave të ndryshme, duke bërë kështu edhe transferimin e tyre në tregun e punës. Ai ka theksuar se duhet një koordinim më i madh mes bizneseve dhe institucioneve arsimore për ofrimin e mundësive të përfundimit të praktikave të ndryshme të cilat pastaj reflektohen drejtpërdrejt në aftësimin profesional të të rinjve duke shmangur kështu edhe largimin e tyre nga vendi.



Auditori i Përgjithshëm, pjesë e takimit vjetor të Komitetit të INTOSAI-it për ngritje të kapaciteteve

TOKIO, 2 KORRIK (ER) - Në Tokio të Japonisë po mbahet takimi vjetor i Komitetit të INTOSAI-it për Ngritje të Kapaciteteve, ku po merr pjesë Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, dhe zëvendësauditori i përgjithshëm, Ilir Salihu. Temë kryesore e takimit është "Eksplorimi i kapaciteteve për ta mbështetur profesionalizmin e institucioneve supreme të auditimit". Përveç temës kryesore, po diskutohet edhe për katër shtyllat kryesore të profesionalizmit: pavarësia e institucioneve supreme të auditimit dhe ndikimi i tyre në menaxhimin më të mirë të fondeve publike; rëndësia e

standardeve për të udhëhequr me profesionalizëm; komponenta e burimeve njerëzore si parakusht për një ISA profesionale; si dhe vlera dhe rëndësia e matjes së performancës së ISA-ve.

Në margjinat e kësaj ngjarje, auditori i përgjithshëm, Besnik Osmani, ka zhvilluar takime të veçanta me homologët e vet nga vende të ndryshme të botës. Fokusi kryesor i bisedës gjatë këtyre takimeve ishte integrimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit në organizatat globale dhe rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit për sektorin publik. Po ashtu, është biseduar edhe për mundësitë e përfitimit nga



programet profesionale si dhe për mundësitë e shkëmbimit të përvojave bilaterale dhe ndër-institucionale. Komiteti për Ngritje të

Kapaciteteve është një nga katër organet kryesore të INTOSAI-it, i cili mbështet iniciativat për ndërtimin e aftësive dhe zhvillimin e

kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit përmes trajnimeve, asistencës teknike dhe aktiviteteve të tjera zhvillimore.

Lekaj: Aeroporti "Adem Jashari", storie suksesi e partneritetit publiko-privat

PRISHTINË, 2 KORRIK - (ER) Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka pritur të martën në takim drejtorin menaxhues të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", Haldun Kokturk, me të cilin ka biseduar për mbarëvajtjen e punëve të përditshme dhe përparimin në zgjerimin e pistës. Në profilin e tij në "Facebook",

Lekaj ka shkruar se ky aeroport është një storie suksesi e partneritetit publiko-privat. "Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari' është storie suksesi e partneritetit publiko-privat. Tashmë kur numri i udhëtarëve ka kaluar dymilionëshin dhe trendi i rritjes është në ngritje e sipër, kërkohet angazhim edhe më i

madh nga stafi menaxhues me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira. Për mbarëvajtjen e punëve të përditshme, përparimin në zgjerimin e pistës, planet e reja që 'Limak' parasheh në ANP 'Adem Jashari', diskutuam me drejtorin menaxhues të këtij aeroporti, Haldun Kokturk", ka shkruar Lekaj.



Fillojnë punimet për rehabilitimin e linjës së 10 hekurudhore të segmentit Fushë-Kosovë - Hani i Elezit e cila do të modernizohet brenda dy vjetësh

Haradinaj thotë se duhet të bëhet një linjë hekurudhore Kosovë - Durrës

"Është jashtëzakonisht interes i gjithë BE-së dhe qytetarëve të saj që të ketë një linjë hekurudhore Kosovë - Durrës dhe në Portin e Durrësit të ketë edhe një dalje hekurudhore në det jo vetëm për ekonominë tonë, por edhe ekonominë e tjera që lidhen në drejtimin tonë", ka thënë kryeministri Haradinaj në ceremoninë e fillimit të punimeve për rehabilitimin e linjës së 10 hekurudhore të segmentit Fushë-Kosovë - Hani i Elezit



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryeministri Ramush Haradinaj të martën ka shprehur nevojën për një linjë hekurudhore me Shqipërinë dhe Malin e Zi. "Është jashtëzakonisht interes i gjithë BE-së dhe qytetarëve të saj që të ketë një linjë hekurudhore Kosovë-Durrës dhe në Portin e Durrësit të ketë edhe një dalje hekurudhore në det jo vetëm për ekonominë tonë, por edhe për ekonominë e tjera që lidhen në drejtimin tonë", ka thënë kryeministri Haradinaj në ceremoninë e fillimit të punimeve për rehabilitimin e linjës së 10 hekurudhore të segmentit Fushë-Kosovë - Hani i Elezit, organizuar nga Zyra e BE-së në bashkëpunim me "Infrakos"-in.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj fil-

limisht ka thënë se në këtë ditë, pra më 2 korrik, dikur të zgjedhurit tanë në Kaçanik u angazhuan, punuan për fatin tonë politik dhe ekonomik dhe, po sot, janë mbledhur së bashku për të shënuar një ngjarje të re që ka disa dimensione të rëndësishme. Haradinaj ka thënë se parakusht për zhvillim të një vendi është një plan i mirëfilltë i zhvillimit ekonomik dhe si parakusht për atë zhvillim përmendi resurset njerëzore, si, aftësimi i njerëzve, sidomos në arsimin dual, pastaj infrastruktura, e cila është në përparim e sipër, mirëpo që ngecet me atë hekurudhore. "Ka qenë e domosdoshme të fillohet me rehabilitimin e kësaj linje hekurudhore deri në Hani të Elezit, por është shumë me rëndësi të vazhdohet me ritëm të njëjtë që të përmbillet infrastruktura hekurudhore", është shprehur

Haradinaj, duke falënderuar taksapaguesit e BE-së për donacionin dhe partnerët financiarë për kredinë e dhënë. Kryeministri Haradinaj ka përmendur disa aspekte të tjera infrastrukturore që sfidojnë, si ajo energjetike, ujore, ku e para është e vjetruar edhe në prodhim edhe në distribucion prandaj, sipas tij, me kujdes duhet të ecet drejt konsolidimit të një infrastrukture energjetike dhe në atë ujore. Kryeministri ka theksuar se ka vështirësi në trajtimin e ujërave të zeza, por Kosovës i mungon edhe infrastruktura e gazit natyror, që Kosova është ndër tregjet e rralla që nuk ka fare gaz natyror. "Kosovës i duhet të krijojë rezerva të ujit dhe rasti i Gjilanit flet se si mund të arrihet te krizat. Prandaj duhet marrë veprime paraprake që të krijohen ujëmbledhës", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se ndihet mirë që sot po nisat rikthimi i linjës hekurudhore në drejtim të Hanit të Elezit dhe, po ashtu, që me këtë intensitet të mbeten deri në Mitrovicë dhe Leshak.

Pal Lekaj, ministër i

Infrastrukturës dhe Transportit, ka thënë se modernizimi i hekurudhave është një nga projektet e mëdha infrastrukturore që po bëhen dhe që janë në pritje të realizohen në Kosovë. Ai ka theksuar se linja hekurudhore Fushë-Kosovë - Hani i Elezit modernizohet brenda dy vjetësh. Lekaj ka shtuar se rehabilitimi i linjave hekurudhore i kthen qytetarët kah transporti hekurudhor, si një faktor kryesor për zhvillimin ekonomik dhe parakusht për ardhjen e investitorëve të huaj në vend.

Prandaj tha se ndihet i lumtur që shumë shpejt do të fillojnë punimet edhe në fazën e dytë të linjës së 10 hekurudhore, Fushë-Kosovë - Mitrovicë, rreth 36 kilometra, për të vazhduar edhe me projektin e linjës R7, Fushë-Kosovë - Podujevë, me gjatësi rreth 45 kilometra dhe atë Prishtinë - Fushë-Kosovë - Aeroporti me gjatësi rreth 20 kilometra.

Agron Thaçi, kryeshef i "Infrakos"-it, ka thënë se projekti për rehabilitimin dhe modernizimin e linjës së 10 hekurudhore

paraqet një nga projektet më të rëndësishme infrastrukturore me mbështetjen më të madhe deri më tash që Kosova ka përfituar nga korniza për investime në Ballkanin Perëndimor, e Bashkimit Evropian dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Ai ka thënë se me këtë projekt parashihet të bëhet rehabilitimi dhe modernizimi i linjës së 10 hekurudhore nga Hani i Elezit në Leshak, me gjatësi prej 150 kilometrash, që njëkohësisht është linja kryesore ndërkombëtare që lidh Kosovën me rajonin dhe Evropën.

Rehabilitimi i hekurudhave të Kosovës (faza e parë dhe e dytë) në gjatësi prej 150 kilometrash do të kushtojë rreth 208 milionë euro, kurse mjetet financiare janë siguruar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Banka Evropiane për Investime, prej të cilave rreth 80 milionë euro janë donacion i BE-së.

Modernizimi i linjave hekurudhore do të bëhet sipas standardeve më të larta të sigurisë dhe lejon zhvillim të shpejtësisë deri në 120 kilometra në orë.



Tërhiqen tri njësi nga shitja e aseteve me likuidim nr. 48

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka njoftuar se ka tërhequr nga tenderi i shitjes Njësinë nr. 12; Njësinë nr. 15 dhe Njësinë nr. 38.

Sipas njoftimit të AKP-së, të gjitha këto prona ishin paraparë për t'u shitur përmes Shitjes së Aseteve përmes Likuidimit nr. 48 e cila do të mbahet më 17 korrik.

Lista e aseteve që janë në shitje përmes Shitjes së Aseteve nr. 48 përfshinë asete të ndërmarrjeve shoqërore nga regjione të ndryshme të Kosovës dhe mund të gjendet

në uebfaqen e AKP-së. Dorëzimi i ofertave do të mbahet më 17 korrik në sallën e "Grand Hotelit" në Prishtinë, kur edhe do të mbahet ceremonia e hapjes së ofertave.



UNMIK-u dhuron katër kompjuterë dhe dy laptopë për NjKDNj-në në Kamenicë

KAMENICË, 2 KORRIK (ER) - Koordinatorja e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NjKDNj), Nazmije Demolli-Kastrati, ka pranuar donacionin nga përfaqësue-

sit e UNMIK-ut. Përfaqësuesit e UNMIK-ut, Xhavit Fejza dhe Nevzad Qorrolli, kanë dorëzuar donacion katër kompjuterë dhe dy laptopë për Zyrën e

Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Kamenicës. Ata kanë përgëzuar koordinatoren e NjKDNj-së, Demolli-Kastrati për punën që është

duke bërë, ndërsa koordinatoren i ka falënderuar përfaqësuesit e UNMIK-ut për donacionin dhe mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kamenicës.




Largohen shitësit mobilë që shfrytëzojnë hapësirat brenda Qendrës Historike të Prizrenit

PRIZREN, 2 KORRIK (ER) - Drejtorja e Inspektorateve në Prizren ka vazhduar aksionin për largimin e shitësve mobilë të cilët shfrytëzojnë hapësirat publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit pa posedim të lejes nga organet kompetente. Komuna e Prizrenit ka njoftuar

se aksioni ka filluar nga fundjava që e lëmë pas dhe do të vazhdojë edhe në ditët e ardhshme për të pasur më pas mbikëqyrje të vazhdueshme nga Inspektorati. "Shfrytëzimi i hapësirave publike pa lejen e organeve kompetente është veprim i jashtëligjshëm, veçmas

kur këto hapësira janë brenda Qendrës Historike, zonë kjo e cila është e mbrojtur me ligj të veçantë. Shitësve që nuk kanë poseduar leje me këtë rast u janë shqiptuar gjoba mandatore dhe u është sekuestruar malli", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Komuna e Prishtinës dhe BE-ja koordinohen për aktivitetin 'Dita pa vetura'



PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Nënkrjetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, ka pritur në takim Annette Fath Lihqi, këshilltare ekzekutive e përfaqësueses speciale të Bashkimit Evropian në Kosovë. Në këtë takim është diskutuar rreth mundësisë së bashkëpunimit dhe mbështetjes së konferencës njëjavore "Java e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë/Kosovo Sustainable Development Week" që do të mbahet në shtator.

Në kuadër të aktiviteteve të kësaj ngjarje do të organizohet

në kryeqytet edhe "Dita pa vetura".

Nënkrjetari Nushi është pajtuar ta ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e aktiviteteve, në veçanti "Dita pa vetura", gjatë së cilës do të ndalohet qarkullimi me vetura në disa pjesë të Prishtinës dhe do të organizohen aktivitete kulturore.

Komuna e Prishtinës është e përkushtuar që ta rritë vetëdijen për rëndësinë e mjedisit të pastër dhe t'i zhvillojë dhe zbatojë politikën për mbrojtje të mjedisit ku jetojmë.

Agim Veliu rizgjedhet kryetar i LDK-së në Podujevë

PODUJEVË, 2 KORRIK (ER) - Agim Veliu është rizgjedhur kryetar i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Podujevë. Sipas njoftimit të LDK-së, gjatë gjithë procesit zgjedhor ka pasur interesim të madh të qytetarëve dhe anëtarësisë për përfshirje në proceset dhe

aktivitetet e LDK-së. "Veçanërisht ky proces u karakterizua me përfshirje të shumë të rinjve. Dega në Podujevë mbetet bastion i LDK-së dhe ky proces demokratik rikonfirmon fuqinë e LDK-së për rezultatin në zgjedhjet e ardhshme që do ta nxjerrin LDK-në partinë më

të madhe në vend", është thënë në njoftimin për media të kësaj partie. Kryetari i Degës së Podujevës, njëherësh nënkryetar i LDK-së, Agim Veliu, ka shprehur mirënjohje ndaj të gjithë aktivistëve që siguruan gjithëpërfshirje dhe mbarëvajtje në këtë proces.



Asfaltohet rruga "Zenun Beqa" në Ferizaj

FERIZAJ, 2 KORRIK (ER) - Komuna e Ferizajt në kuadër të projekteve infrastrukturore ka bërë asfaltimin e rrugës "Zenun Beqa" në Lagjen e Re të kësaj komune. Kjo rrugë ka një rëndësi të madhe për banorët e asaj ane pasi lidhë këtë zonë të qytetit me rrugët kryesore,

konkretisht rrugën "Vëllezërit Gërvalla".

Për t'i parë nga afër punimet në këtë rrugë ka dalë drejtori i Infrastrukturës në Ferizaj, Arbër Bytyqi, i cili ka theksuar se kjo rrugë është bashkëfinancuar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. "Vlera e kon-

tratës së këtij projekti është rreth 133 000 euro, e nënshkruar me operatorin ekonomik. Sot po asfaltojmë shtresën e parë të rrugës 'Zenun Beqa'. Në ditët në vijim do të asfaltohet edhe shtresa e dytë", ka thënë ai, duke shtuar se nga MAPL-ja kanë siguruar 77 mijë euro.

Themelohet Qendra 'Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur'

Në Bernë të Zvicrës është themeluar Qendra "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur", e cila ka për qëllim të shndërrohet në rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh, të cilët angazhohen vullnetarisht për informimin e drejtë dhe ndriçimin e plotë të gjenocidit në Kosovë. Nismëtarët e themelimit të kësaj qendre vendosën t'ia besojnë udhëheqjen e saj politologut Bardhyl Mahmuti

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 KORRIK - Më 30 qershor 2019, në Bernë të Zvicrës, u themelua Qendra "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur", e cila ka për qëllim të shndërrohet në rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh të cilët angazhohen vullnetarisht për informimin e drejtë dhe ndriçimin e plotë të gjenocidit në Kosovë dhe të këmbëngulin në domosdoshmërinë e ngadhënjimit të drejtësisë.


Në takimin e 30 qershorit u miratua logoja e qendrës, ku katër petalet e lulëkuqes paraqesin katër format e veprimeve të gjenocidit që u zbatuan në Kosovë: vrasjet, dhunimet seksuale, spastrimi etnik dhe shkatërrimi i objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.

Ndërsa në vend të kokrave të zeza të lulëkuqes, në logo janë prezantuar figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash për të përfshirë të gjitha kategoritë e shqip-

tarëve që ishin shndërruar në objekt shkatërrimi nga politika e gjenocidit të Serbisë.

Nismëtarët e themelimit të kësaj qendre vendosën t'ia besojnë udhëheqjen e saj politologut Bardhyl Mahmuti. "Ftojme të gjithë ata të cilët janë të interesuar që vullnetarisht të ndihmojnë për ndriçimin e gjenocidit në Kosovë, kudo qofshin në botë, t'i bashkëngjiten qendrës 'Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur' dhe ta japin kontributin e tyre për ta bërë të njohur në çdo cep të globit tragjedinë që ka përjetuar populli shqiptar i Kosovës", është thënë në njoftimin e kësaj qendre.

Sipas Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur", gjatë luftës së viteve 1998-1999 Kosova u shndërrua në "Teatër me dyer të mbyllura", ku shteti serb vuri në skenë tragjedinë shqiptare, ndau rolet e aktorëve, dirigjoi çdo veprim në operationet luftarake të ndërmarra me qëllim shkatërrimin e tërësishtëm ose të pjesëshëm të shqip-



tarëve dhe në fund rrënoi skenografinë ku u krye gjenocidi. "Megjithatë krimet e tmerrshme të gjenocidit dhe tragjedia e shqiptarëve të Kosovës nuk mundi të mbahej e fshehur. Ndërhyrja e shteteve demokratike perëndimore i dha fund barbarisë serbe dhe mundësoi të dilnin në shesh vrasjet e mbi dhjetë mijë shqiptarëve, dhunimet seksuale të mbi njëzet mijë femrave shqiptare, spastrimi etnik i Kosovës me

dëbimin e shumicës dërrmuese të shqiptarëve dhe asgjësimin e dokumenteve të identifikimit, shkatërrimi i 100 589 shtëpive, i 8 8101 objekteve përcjellëse, i 358 shkollave, i 30 shtëpive kulturore, i monumenteve historike, i 93 bibliotekave, i 123 institucioneve shëndetësore dhe i 220 objekteve të kultit fetar (xhami, teqe, tyre dhe kisha katolike)...", është thënë në deklaratën për media të Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur".

Sipas kësaj qendre, 20 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë nuk dihet asgjë për fatin e mbi 1 600 personave, gjurmët e të cilëve u zhdukën nga forcat serbe. "Gjenocidi në Kosovë është një plagë e hapur që kërkon trajtim të drejtë! Mohimi i gjenocidit paraqet fyerje të rëndë ndaj viktimave, ndaj familjarëve të tyre dhe kombit ndaj të cilit është kryer gjenocidi. Ballkani Perëndimor ka nevojë për paqe, por ardhmëria paqësore nuk mund të ndërtohet mbi gënjeshtër dhe mohim të krimeve. Mohimi i gjenocidit minon ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Njohja, pranimi dhe dënimi i gjenocidit në Kosovë ndihmojnë në shërimin e plagëve të hapura dhe mundësojnë që një ditë të bëhen realitet premtimet e shpeshta për 'kurrë më gjenocid', është theksuar në këtë deklaratë

Qendra "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur" synon të shndërrohet në rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh të cilët angazhohen vullnetarisht për informimin e drejtë dhe ndriçimin e plotë të gjenocidit në Kosovë dhe këmbëngulin në domosdoshmërinë e ngadhënjimit të drejtësisë. "Jemi të bindur se ndriçimi i plotë i kësaj tragjedie njerëzore kontribuon në parandalimin e gjenocideve të reja kudo qoftë në botë", është theksuar në deklaratën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur".

Ministria e Tregtisë verifikon peshoret e mullinjve para sezonit të korrje-shirjeve



Kryeinspektori i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Lulzim Sylja, u ka bërë thirrje grumbulluesve dhe pronarëve të fabrikave të miellit që ta bëjnë verifikimin e peshoreve, përndryshe mund të gjobiten. Verifikimi i peshoreve do të vazhdojë në të gjitha komunat e Kosovës

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Me vendim të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, të martën Agjencia e Metrologjisë bashkë me Inspektoratin kanë bërë verifikimin e peshojave të mëdha. Verifikimi është duke u bërë para fillimit të sezonit të

korre-shirjeve me qëllim që të mos mashtrohet konsumatori. Kryeshefi i agjencisë së Metrologjisë, Ferki Fejza, ka thënë se qëllimi kryesor i kësaj vizite është verifikimi i peshoreve në mbrojtje të konsumatorit. Fejza ka theksuar se

inspektimet e tilla do të bëhen edhe në qytete të tjera të Kosovës. "Qëllimi i vizitës është verifikimi i jashtëzakonshëm për të gjitha pikat grumbulluese dhe fabrikat e miellit në këtë prag të fillimit të korrje-shirjes, verifikimi i peshoreve në pika



grumbulluese në funksion të mbrojtjes së konsumatorit duke pasur parasysh se kjo është një ndër parimet themelore edhe të Ministrisë së Tregtisë, edhe të ministrit Endrit Shala. Ky aktivitet është në përmbushje të obligimeve ligjore që dalin nga ligji për metrologjinë", ka thënë Fejza.

Ndërsa kryeinspektori i Ministrisë së Tregtisë, Lulzim Sylja, ka bërë thirrje te grumbulluesit që ta bëjnë verifikimin e

peshoreve, përndryshe mund të gjobiten. "Inspektorati i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë iu bënë thirrje të gjithë grumbulluesve që ta bëjnë verifikimin e peshoreve, në të kundërtën, nëse nuk bëjnë verifikimin, inspektorati i cili është në terren do të marrë masa sipas ligjeve në fuqi", ka thënë Sylja.

Verifikimi i peshoreve do të vazhdojë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

E rrallë

Suedia ndalon duhanin edhe në vendet publike

Që nga 1 korriku suedezët janë të ndaluar me ligj që të pinë cigare në disa hapësira publike, përfshirë parqet e lojërave, stacionet e trenave, madje edhe jashtë restoranteve dhe bareve. Ndalimi përfshin edhe cigaret elektronike. Sipas statistikave të Bashkimit Evropian, Suedia është vendi me përqindjen më të ulët të duhanpirësve të përditshëm.



BARSOLETA E DITËS



Shkon gjakovari në ëmbëltore:
- Më falni, sa kushton trileqja?
Kamerieri:
- Një euro e gjysmë.
Gjakovari:
- Atëherë sillma një njëleqe.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
“X-Men; Dark Phoenix”

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,
Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00
“M A”

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një polic shihet pranë makinave të mbuluara nga breshëri që ra në Meksikë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Një gur shahu u ble për 6 dollarë, në ankand shitet për miliona dollarë

Një gur shahu nga mesjeta, i mbajtur në sirtarin e një shtëpie në Edinburg, mund të shitet për 1.3 milion dollarë në ankand. Pronarët e saj nuk e kishin idenë se objekti ishte një nga gurët e humbur të Lewis Chessmenit. Guri i shahut i



fildishtë u gjet i varrosur në një dunë rërë në Isle of Lewis në vitin 1831, por vendndodhja e pesë gurëve të tjerë ka mbetur mister. Gjyshi i familjes Edinburg, një tregtar antikash, e kishte blerë për gjashtë dollarë në ankand.

<p>DASHI Jeni shumë të hapur dhe prisni që dhe të tjerët të kenë të njëjtën sjellje karshi jush. Harroni që njerëzit janë të ndryshëm.</p>	<p>DEMI Persona që i mendoni të afërt nuk ju janë gjendur pranë në çastet tuaja më të vështira. Sot do t'ua thoni përballë këtë gjë.</p>	<p>BINJAKËT Gjatë ditës së sotme do t'ju lindin mundësi të reja që do të jenë shumë fitimprurëse dhe mjaft argëtuese. Do të pranoni çdo sfidë.</p>	<p>GAFORRJA Sot doni të çlodheni dhe mënyra e vetme është një aktivitet artistik ose takimi me njerëz të mirë dhe që ju kuptojnë.</p>	<p>LUANI Sot do të përballeni me një person që ka hapur një keqkuptim të madh midis jush dhe kolegëve tuaj. Masat që do të merrni do të jenë drastike.</p>	<p>VIRGJËRISHA Po merrni vendime jo shumë popullore. Do të ndikoni në distancën që do të krijohet mes jush dhe miqve tuaj.</p>
<p>PESHORJA Kërkoni gjatë gjithë kohës që t'ju mirëkuptojnë, por kjo kërkese e vazhdueshme mund të ketë efekte negative dhe mund të mos arrini asgjë.</p>	<p>AKREPI Keni pasur gjithë kohës mbështetjen e familjarëve tuaj në çështje të ndryshme. Duhet të filloni të mësoni të ecni vetë me këmbët tuaja.</p>	<p>SHIGJETARI Duhet të mësoni t'i bëni gjërat hap pas hapi dhe do të shikoni që do të arrini të zgjidhni gjithçka. Plane të reja për një vend të ri pune.</p>	<p>BRICJAPI Projektet personale do të jenë ato që kanë precedencën sot. Do të arrini të zgjidhni një mosmarrëveshje në ambientin tuaj të punës.</p>	<p>UJORI Një person që për ju është i veçantë do t'ju zbulojë një anë aspak të mirë të karakterit të tij. Nuk do të dini se si të veproni në të ardhmen.</p>	<p>PESHQIT Sot keni një ndjesi që nuk do të arrini t'i përfundoni të gjitha gjërat që keni marrë përsipër. Kërkoni ndihmë nëse e shihni të nevojshme.</p>

Edhe një këngë e re nga Camila Cabello



Camila Cabello ka paralajmëruar edhe një këngë të re. Këngëtarja 22-vjeçare në rrjetin social "Instagram" ka postuar një video të shkurtër me anë të së


cilës ka njoftuar se një projekt i ri muzikor, pjesë e albumit të saj, vjen së shpejti. "Gotta go", ka shkruar ajo. Camila së fundmi ka bashkëpunuar me Shawn Mendes.

Kit Harington del publikisht për herë të parë pas rehabilitimit



Kit Harington dhe gruaja e tij, Rose Leslie, u panë bashkë për herë të parë pasi aktori doli nga rehabilitimi. Ylli 32-vjeçar i "Game of Thrones" dhe 32-vjeçarja u panë duke ecur rreth rrugëve të Londrës, saktë-

sisht në lagjen Soho. Muajin e kaluar u raportua se Kit Harington ishte në rehabilitim për stres dhe alkool. Atëherë, Kit sapo kishte përfunduar një turne të madh shtypi për sezonin e fundit të "Game of Thrones".



Selena Gomez shkëlqen në të kuqe në Meksikë

Këngëtarja Selena Gomez ka nisur pushimet. Ajo është duke qëndruar në Meksikë. Gomez ka shkëlqyer

në rroba të kuqe banje duke shfaqur kështu edhe fizikun e saj teksa po dilte nga ujërat e kristalta të Meksikës.

Chris Martini mohon të jetë puthur me Dua Lipën



Këto ditë ka pasur thashetheme se Chris Martini është parë duke u puthur me Dua Lipën në skenën e festivalit Glastonbury në fundjavën që lamë pas. Por, 42-vjeçari, solisti i Coldplay, ka mohuar spekulimet se ai ka puthur 23-

vjeçaren. "Ne duam të konfirmojmë se Chris Martin dhe Dua Lipa nuk u puthën në Glastonbury dhe janë vetëm miq. Ata të dy ishin në të njëjtën zonë me një grup të madh miqsh", ka deklaruar një përfaqësues i Chris për "Daily Mail".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Ligji për Sponsorizim jep shkëndijat e para

Skuadra e Ferizajt, e cila bën pjesë në Superligën e Kosovës dhe Besa e Pejës, si një ndër skuadrat më të trofeshme në vend, pritet të forcohen financiarisht dhe të jenë skuadra serioze në edicionin 2019/2020 pas miratimit të Ligjit për Sponsorizim në Kuvendin e Republikës së Kosovës



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 KORRIK - Miratimi i Amendamentit numër 5 që ka të bëjë me Ligjin për tatimin në të ardhurat në korporata ka filluar t'i japë shkëndijat e para në sport, konkretisht në futboll. Klubi i Ferizajt, i cili bën gara në rangun më të lartë të futbollit në Kosovë, pra në IPKO Superligë, ka paralajmëruar se shumë shpejt klubi pritet të privatizohet nga biznesmenë të fuqishëm në Komunën e Ferizajt, por ka të tillë të interesuar edhe nga jashtë. "KF Ferizaj së shpejti pritet të privatizohet nga një grup i firmave më të mëdha të qytetit tonë, gjithashtu interesim për ta privatizuar klubin tonë kanë shprehur edhe disa investitorë jashtë vendit tonë.

Brenda kësaj jave pritet të finalizohet marrëveshja dhe t'i fillojmë menjëherë përfundimet në klub, që të jemi sa më konkurrentë në sezonin e ardhshëm", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ferizajt.

Një tjetër klub i madh në futbollin e Kosovës, Besa e Pejës, shumë shpejt mund të këndellet në aspektin financiar, pasi biznesmenët e fuqishëm nga qyteti i Pejës do të investojnë në këtë klub, i cili ka hequr shumë në aspektin financiar në vitet e fundit dhe, si pasojë e kësaj, ka rënë në Ligën e Parë dhe është pjesë e saj për të dytin vit me radhë. Klubi pejan humbi shansin për t'u rikthyer në Superligë, pasi humbi në barazh nga Gjilani dhe që nga atëherë ka vazhduar një heshtje e madhe publike, por në prapaskenë janë duke u

zhvilluar bisedime që pronari i "Elkos Grupit", Ramiz Kelmendi dhe ai i korporatës "Dukagjini", Ekrem Lluka, të investojnë në skuadrën e Besës në mënyrë që ajo të rikthehet në majat e futbollit të Kosovës. "Shumë shpejt pritet që biznesmenët Ramiz Kelmendi dhe Ekrem Lluka të investojnë në skuadrën e Besës", ka thënë një burim i gazetës brenda skuadrës pejane. Edhe një nga lojtarët më të mirë në futbollin e Kosovës, Dugagjin Gashi, ka vendosur të rikthehet në skuadër. Plani është që në "Shahin Haxhiislami" të mbesin disa nga lojtarët kryesorë dhe shumë të tjerë të "aterojnë" gjatë këtij afati kalimtar. Gazeta mëson se edhe Fisnik Papuqi do të rikthehet në skuadrën e Besës me të cilin arriti sukseset më të mëdha si futbollist.

SHKURT

'Dugi' lë Dukagjinin, shkon te Besa

Mesfushori Dugagjin Gashi ka vendosur për të ardhmen e vet. "Dugi" është larguar përfundimisht nga Dukagjini i Klinës dhe ka vendosur të rikthehet në skuadrën e zezës, Besën e Pejës. Marrëveshja në mes të Gashit dhe Besës arritur, kurse zyrtarizimi do të bëhet gjatë ditëve të ardhshme. Krahas këtij futbollisti, Besa pritet të bëjë edhe transferime të tjera me synim për t'u rikthyer në IPKO Superligë. "Dugi" ka luajtur edhe për Vëllaznimin, Feronikelin, Drenicën dhe Istogun.

Berisha të enjten prezantohet te SPAL-i

Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, të enjten do të zyrtarizohet te skuadra e SPAL-it. Ish-portieri i 2 Korrikut të Prishtinës është paraqitur në 18 ndeshje për skuadrën e Atalantës, por mbetet portieri i dytë pas Pierluigi Gollinit. 30-vjeçari gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Lazion dhe Kalmarin, ndërsa për kombëtaren kuqezi është paraqitur në 58 ndeshje.

Tumbaković: Ja pse nuk e drejtova Malin e Zi ndaj Kosovës

Ljubisa Tumbaković gjatë ditës së djeshme është bërë trajner i kombëtares serbe të futbollit. Strategu 66-vjeçar, i cili udhëhoqi për tre vjet kombëtaren malazeze, nuk kishte pranuar të drejtonte Malin e Zi kundër Kosovës.

Trajneri ka folur për herë të parë rreth rastit të muajit të kaluar duke treguar se pse e tradhtoi Malin e Zi. "Vendimi për mos e drejtuar ekipin malazez kundër Kosovës ishte lëvizje logjike dhe korrekte. Atë vendim e kam marrë vetë, nuk më ka shtyrë askush. Koha do ta tregoj nëse kam të drejtë", ka thënë Tumbaković. Më pas ai u përgjigj në pyetjet e gazetarëve nëse do ta drejtonte Serbinë kundër Kosovës, duke thënë se për një gjë të tillë do të vendosë shteti.

Prishtina eliminohet nga Liga e Evropës

PRISHTINË, 2 KORRIK - Skuadra e Prishtinës është eliminuar nga Liga e Evropës, pasi pësoi humbje në ndeshjen e kthimit ndaj St Joseph's (2-0). Skuadra nga kryeqyteti i Kosovës luajti më mirë në pjesën e parë, por i mungoi finalizimi i aksioneve, derisa në fillim të pjesës së dytë gjerat për Prishtinën u vështirë-

suan për faktin se u përjashtua nga loja pas dy kartonëve të verdhë, Leotrim Bekteshi, kurse nga loja u përjashtua edhe kapiteni Armend Dallku pas kartonit të kuq. Epërsinë numerike e shfrytëzoi për mrekulli skuadra vendase që realizoi dy gola të shpejtë. Në minutën e 75-të, Villar realizoi për 1-0,

derisa pesë minuta më vonë Juan Penaloza e vulosi rezultatit final 2-0. Në minutat shtesë Ezequiel Rojas u përjashtua nga loja. Ndeshja e parë e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë kishte përfunduar 1-1, dhe St Joseph's kualifikohet në rrethin e parë eliminator me rezultat të përgjithshëm 3-1.



Behrami rikthehet në Zvicër

SION, 2 KORRIK - Ish-mesfushori i Kombëtares së Zvicrës, Valon Behrami, është larguar nga Italia dhe është rikthyer në Zvicër. Mesfushori është ndarë nga Udinese dhe ka vendosur të rikthehet në

skuadrën e Sionit. Ai ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën zvicerane. "Një luftëtar i përlurur dhe lider, vlera unike për rajonin tonë. Mirë se erdhe në Valais, Valon!", ka shkruar Sion në

prezantimin e 34-vjeçarit. Shqiptari nga Mitrovica ka luajtur për këto klube: Lugano, Genoa, Verona, Lazio, West Ham United, Fiorentina, Napoli, Hamburger, Watford, Udinese.



Hasani propozon që sportistët elitarë të bëhen pjesë e FSK-së



PRISHTINË, 2 KORRIK - Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Rustem Berisha, e ka pritur në takim presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani. Ministri Berisha u shpreh i nderuar për këtë takim dhe përgëzoi Hasanin për sukseset e sportistëve të Kosovës, të cilët, sipas tij, i kanë bërë krenarë të gjithë. Më tej ministri i informoi zyrtarët e KOK-ut rreth procesit të tranzicionit të FSK-së dhe arritjeve gjatë fazës së parë 120-ditëshe pas miratimit të ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-së. Në takim u diskutua rreth formalizimit të bashkëpunimit të KOK-ut me FSK-në në fushën e sportit. "Kjo

do të ndikonte edhe në masivizimin e sportit të të rinjve të vendit tonë", ka thënë ai. Presidenti Hasani shprehu gatishmërinë që KOK-u ta përkrahë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në për organizimin e pjesëtarëve të FSK-së nëpër klube në disiplina të ndryshme sportive, organizimin e garave si dhe themelimin e federatës ushtarake të sporteve brenda FSK-së. "FSK-ja në radhët e saj ka të përgatitur sportistë të cilët me sukses mund të garojnë në gara ndërkombëtare", ka deklaruar Hasani. Duke ndjekur praktikën e mira të disa ushtrive në Evropë, presidenti Hasani propozoi që disa nga elitarët e

sportistëve të Kosovës të mund të bëheshin pjesëtarë të FSK-së. Ministri Berisha e përkrahi këtë ide dhe është zotuar se do të hulumtohen modalitetet më të përshtatshme që sportistët elitarë ta respektojnë FSK-në si pjesëtarë në uniformë, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi. Ministri Berisha dhe presidenti i KOK-ut, Hasani, u pajtuan që pa vonesë të themelohen grupet punuese nga të dyja palët për hartimin e një memorandum bashkëpunimi me qëllim të thellimit të bashkëpunimit institucional ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komitetit Olimpik të Kosovës.

Klitschko përjashton rikthimin në boks

KIEV, 2 KORRIK - Wladimir Klitschko ishte shumë pranë rikthimit në sportin e boksit pasi kompania mediatike "DAZN" i ofroi një çek me vlerë 50 milionë dollarë për t'u rikthyer në sportin ku së bashku me vëllanë e tij, Vitalin, dominuan për më shumë se një dekadë. Në një intervistë për medien britanike "The Sun", 43-vjeçari tregoi se nuk ka ndërmend të kthehet në boks profesionist, pasi tani e ardhmja e tij është e fokusuar në rolin si promotor. "Ndihehem në paqe pas vendimit për t'i dhënë fund karrierës. Në karrierën time mësimet më të rëndësishme i kam marrë duke humbur. Asnjë fitore nuk më ka mësuar aq shumë se në ato pak raste kur kam humbur. Gjithmonë mendoja se humbja ishte një dëshim total, por pas duelit kundër Joshua's kuptova se në boks ka



dhe humbje dinjitoze. Tani jam i fokusuar në karrierën time të dytë si promotor me kompaninë

time K2. Betejat e mia vazhdojnë, por tani jo më në ring", ka thënë Klitschko.

SHKURT

PSG-ja zyrtarizon Sarabian

Kampioni i Francës, Paris Saint-Germain, ka kryer zyrtarizuar Pablo Sarabia Garcian si transferimin e parë në këtë afat kalimtar. PSG-ja e transferoi Sarabian nga Sevilla, për shifrën e 18 milionë eurove, aq sa ishte edhe klauzola e largimit të tij, edhe pse vlera e tij në treg llogaritet të jetë 40 milionë euro. Mesfushori me tipare sulmuese ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare, me pagë katër milionë euro në sezon.

Conte nuk i dëshiron Icardin dhe Nainggolanin

Trajneri i Interit, Antonio Conte, ka kërkuar nga klubi që sa më parë të shesin Mauro Icardin dhe Radja Nainggolanin. "Daily Mail" raporton se Conte u ka kërkuar drejtuesve të klubit që ta shesin sulmuesin Icardi dhe mesfushorin Nainggolan, pasi karakteri i lojtarëve nuk është i duhur dhe në ekip duhet të ketë vetëm lojtarë që derdhin gjak për Interin. Nga shitja e këtyre dy lojtarëve planifikohet transferimi i Romelu Lukakut (Manchester United) dhe Arturo Vidalit (Barcelona).

39-vjeçari Emre Belozoglu rikthehet te Fenerbahçe

Emre Belozoglu është një legjendë e gjallë e futbollit turk. Mesfushori i njohur mbush 39 vjeç në shtator, por moshë nuk e pengon aspak të vazhdojë të luajë në nivele të larta. Emre la Fenerbahçen në vitin 2015 për t'u transferuar tek ekipi i Bashakshehirit, ndërsa tani ka ndodhur e kundërta. "Veterani" ka ndërprerë kontratën me nënkampionët e Turqisë dhe është rikthyer te Fenerbahçe, që është edhe skuadra e tij e zemrës. Një vit zgjat kontrata mes palëve, por forma e mirë fizike mund të bëjë që drejtuesit e klubit të famshëm turk t'i ofrojnë një tjetër kontratë në fund të sezonit. Emre është aktivizuar me klube si Interi, Atletico Madrid, Newcastle, Galatasaray, Fenerbahçe dhe Bashakshehir. Me kombëtaren turke ka shënuar 9 gola në 99 ndeshje të zhvilluara.

Thompson iu qëndron besnik Warriorsave

Ndryshe nga Kevin Duranti që u largua për të luajtur me Brooklyn Netsin, basketbollisti Klay Thompson ka vendosur të qëndrojë te Golden State Warriors. "Snajperi" ka rinovuar kontratën me nënkampionët e NBA-së. Thompsoni ka nënshkruar një kontratë të re, pesëvjeçare me Warriorsin, nga e cila do të përfitojë 190 milionë dollarë. Gjithsesi, rikthimi në fushë i Thompsonit do të ndodhë në vitin 2020. Basketbollisti është i dëmtuar dhe nuk pritet të luajë para shkurtit të vitit të ardhshëm.

Rabiot: Juve është një hap mbi PSG-në

Adrien Rabiot është prezantuar nga Juventus. Ai ka thënë se "Zonja e Vjetër" është një hap mbi PSG-në. "Juve është një klub i madh, me shumë prestigj dhe ka një përvojë të madhe në Evropë, edhe pse me disa komplikime në vitet e fundit. Si e shoh unë, Juve është një hap mbi PSG-në", ka thënë Rabioti. "Është koha e duhur që të vija këtu. Kam pasur edhe më parë kontakte me Juven, por tani është një periudhë tjetër e jetës. Kam qenë në Paris për shtatë vjet, është hera e parë që luaj jashtë vendit tim, por dëshira dhe vendosmëria janë të njëjtat. Asgjë nuk do të ndryshojë", ka deklaruar Rabiot.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasleđe / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtinë, 03.07.2019

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149 neni 12 pika 4 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, shpall:

KONKURS për Marrëveshje me Shërbime të Veçanta

Titulli i punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa
Koeficienti: 7
Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta
Kohëzgjatja e emërimit: 6 (gjashtë) muaj
Orët e punës: 40 orë në javë
Raporton: Zyrtarit Kryesor Financiar

Vendi i punës: Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për planifikimin e buxhetit;
- Merr pjesë në hartimin e planeve vjetore buxhetore të institucionit dhe ndihmon zyrtarët përkatës brenda institucionit për të siguruar që planet të kompletohen me përpikëri dhe sipas afatit;
- Evidenton faturat për pagesat në regjistrin përkatës dhe kujdeset për procedimin e tyre me kohë për ekzekutimin e pagesës;
- Kujdeset për plotësimin e obligimeve të organizatës buxhetore duke përfshirë këtu pagesën me kohë e faturave për realizimin e procedurave të pagesave ;
- Bën raportimin javore, mujore për buxhet dhe financa;
- Ndihmon udhëheqësin e drejtëpërdrejtë në planifikimin e buxhetit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathësit e kërkua:

- Fakulteti Ekonomik, Administrimin Biznesi apo Kontabilitet;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Njohuri të thell dhe të specializuar në fushën e financave publike dhe buxhetit;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 kati i II (dytë) zyra nr.206, Prishtinë, Kosovë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Tel: +383 (0) 38 211 617, prej orës 08:00-16:00. Konkursi është i hapur nga data 03.07.2019 deri me datë 10.07.2019.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkojnë për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasleđe / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Priština, 03.07.2019

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo br. 03/L – 149 član 12.4 i Uredbe br. 02/2011 o proceduri regrutiranja u civilnoj službi Republike Kosovo, Savet Kosova za Kulturno Nasleđe, objavljuje:

KONKURS za Ugovor za posebne usluge

Naziv radnog mesta: Službenik za budžet i finansije
Koeficijent: 7
Vrsta ugovora: Ugovor za posebne usluge
Trajanje imenovanja: 6 (šest) meseci
Radno vreme: 40 časova nedeljno
